

# Respect and Care

Partnering with patients for personalized care



## ALBANIAN

### Pse po e kërkojmë ne këtë informacion?

Organizata Shëndetsore e UMass Memorial është e përkushtuar për të ofruar kujdesin më të mirë të mundshëm për çdo pacient. Ne i bëjmë çdo njeriu këto pyetje sepse cdo pacient është i ndryshëm dhe unik dhe ka nevoja specifike për kujdesin shëndetësor.

Në Organizatën Shëndetsore të UMass Memorial ne dëshirojmë t'ju njohim juve më mirë, në mënyrë që ju të ndiheni gjithmonë të mirëpritur dhe të respektuar, dhe që ne të mund t'ju ofrojmë kujdesin më të mirë të mundshëm. Informacioni që ju ofroni n'a ndihmon ne t'ju kuptojmë më mirë, të personalizojmë kujdesin tuaj dhe të përmirësojmë eksperiencën tuaj në UMass Memorial.

Pjesëmarrja juaj është vullnetshme dhe ju mund të zgjidhni të specifikoni që ju preferoni të mos i përgjigjeni asnjë prej këtyre pyetje.

### Kush mund të shikojë informacionin tuaj?

Informacioni që ju ofroni është konfidencial dhe i mbrojtur nga ligji I HIPAA (Akti Ligjor për Sigurimet Shëndetësore mbi Transferimin dhe Përgjegjshmërinë) ashtu si cdo informacion shëndetsor. Informacioni juaj do të jetë pjesë e rekordeve tuaja mjekësore dhe i disponueshëm për të mbështetur kujdesin tuaj shëndetsor.

Nëse dëshironi të kuptoni se si mund të përdoret ose zbulohet informacioni juaj, ju lutemi kërkonte një kopje të Njoftimit tonë të Përbashkët të Praktikave të Privatësisë [Joint Notice of Privacy Practices](#).

### Cfarë informacioni po kërkojmë?

Në mënyrë që ne t'ju kuptojmë më mirë, ne po kërkojmë informacionin e identitetit personal të mëposhtëm:

- **Emri i Preferuar** (emri që dëshironi të përdorin njerëzit kur komunikojnë me ju në person, në myChart, në shiritin tuaj të dorës, në letra dhe fatura të postuara në shtëpinë tuaj, etj.)
- **Gjuhën e Preferuar për informacionin shëndetsor të folur dhe të shkruar**
- **Besimin Fetar**
- **Hispanik/Latino ose jo-Hispanik/jo-Latino**
- **Raca** (ju mund të specifikoni një ose më shumë)
- **Prejardhja Etnike** (vendi, grupi social ose fetar nga vini dhe me të cilin identifikoheni, të tilla si Shqiptarë, Irlandezë, Nigerianë ose Vietnamezë)
- **Orientimi Seksual** (ndaj kujt tërhiqeni nga ana romantike apo seksuale)
- **Informacion mbi Identitetin Gjinor** (sensi juaj i brendshëm për të qenë mashkull, femër ose gjini tjetër)
- **Seksi i Caktuar në Lindje** (çfarë ishte në certifikatën tuaj origjinale të lindjes)

### Ne mund të përdorim këtë informacion për të përmirësuar kujdesin shëndetsor.

Sigurimi i informacionit të mësipërm mund të na ndihmojë:

- Të komunikojmë me ju në gjuhën tuaj të preferuar për të evituar pengesat gjuhësore midis jush dhe ofruesve të kujdesit tuaj shëndetsor.
- Të përdorim përemrat dhe emrin tuaj të preferuar korrektësisht në mënyrë që të ndiheni të mirëpritur dhe të respektuar.
- Të sigurojmë që ne jemi duke ofruar një kujdes shëndetsor mirëpritës ndaj ndryshimeve të kulturave, të barabartë për të gjithë pacientët tanë; dhe të na ndihmojë të identifikojmë dhe adresojmë pabarazitë e kujdesit shëndetsor që mund të përjetohen nga komunitetet e ndryshme që ne u shërbejmë.